



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2020

V E N D I M

Nr. 118, Datë 02/10/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 95, datë 08.09.2020, e znj. D.T., ku pretendohet diskriminim për shkak të “racës”¹, nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesja D.T. i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Shkodrës. Familja e saj, e cila ka banuar në Gjermani për disa vite, në vitin 2019 është rikthyer në Shqipëri. Gjatë periudhës që ankuesja ka jetuar në këtë shtet, ka lindur vajzën e saj, Emily D.T., datëlindja e së cilës është 19.05.2017. Ankuesja pretendon se me rikthimin e saj në Shqipëri, është paraqitur disa herë pranë Zyrës së Gjendjes Civile Shkodër, për të kryer regjistrimin e vajzës së saj, por kjo zyrë ka refuzuar t’i ofrojë këtë shërbim, me arsyetimin se znj. D.T. nuk ka paguar taksat e pushtetit lokal, për periudhën që familja e saj ka jetuar në Gjermani. Për sa më sipër, znj. D.T. pretendon diskriminim për shkak të përkatësisë në komunitetin egjiptian.

¹ Referuar vërtetimit të lëshuar nga Shoqata për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian vërtetohet se znj. D.T., i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Shkodrës.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 95, datë 08.09.2020, e znj. D.T., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua me shkresën nr.1211/1, datë 11.09.2020, Zyrës së Gjendjes Civile Shkodër dhe për dijeni Bashkisë Shkodër dhe ankueses D.T., ku kërkohej informacionmbi pretendimet e parashtruara nga ankuesja.
- 1.** Në përgjigje të shkresës nr. 1211/1, datë 11.09.2020, së Komisionerit, Bashkia Shkodër dërgoi shkresën nr. 12917/1, datë 22.09.2020, nëpërmjet së cilës informon se pas marrjes së informacionit përkatës nga KMD, specialistë të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve pranë këtij institucioni morën detyrën për të kontaktuar dhe komunikuar me znj. D.T.. Nga komunikimi i patur me të rezultoi se pengesa e vetme për mosregjistrimin e fëmijës ka qënë dokumenti për saktësimin e adresës së banimit të shtetases në fjalë.

Në shkresë theksohet fakti se për sa i përket pretendimit për diskriminim nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile Shkodër për shkak të racës, ky pretendim nuk qendron, pasi shtetases në fjalë i është dhënë orientimi i duhur, ashtu sikurse veprohet për të gjithë qytetarët e tjerë dhe ky fakt është konfirmuar dhe nga vetë shtetësja në takimin e realizuar në datën 18.09.2020.

Pas takimit të realizuar me shtetasen D.T., specialistë të Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve e shoqëruan ankuesen pranë specialistit të Regjistrimit Kombëtar të Adresave pranë Bashkisë Shkodër, ku është saktësuar adresa e shtetases D.T. dhe më pas janë përfunduar procedurat e regjistrimit të fëmijës Emily D.T. në gjendjen civile Shkodër.

Bashkëlidhur shkresës nr. 12917/1, datë 22.09.2020, Bashkia Shkodër ka dërguar çertifikatën e regjistrimit të fëmijës.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

Pas informacionit të dërguar nga Bashkia Shkodër, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb. Në referencë të nenit 33, pika 9, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, KMD vlerësoi se është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin ishte iniciuar hetimi administrativ i ankesës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Përfundimin e procedurës së shqyrtimit administrativ të ankesës nr. 95, datë 08.09.2020, e znj. D.T., pasi u arriti efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Robert GAJDA

KOMISIONER

Shkak – raca,
Fusha – të mira dhe shërbime
Lloji i vendimit- arritje efektiviteti